




I. Golej



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2536 / Prot.

17

Vlorë më, 06.11.2024

Handwritten signature

VENDIM

Nr. 66, datë 31.10.2024

PËR

DISA NDRYSHIME/ SHITESA NË VENDIMIN NR.2, DATË 16.01.2024, TË SENATIT AKADEMIK "PËR DISA NDRYSHIME/ SHITESA NË VENDIMIN NR. 75, DATË 13.07.2017, TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM-së nr.112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar", dhe "Profesor"si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, ardhur me shkresë Nr.2403, si dhe pas diskutimit në Rektorat, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin si më poshtë vijon.

Ndryshimin e pikës 1 gërma a e cila:

Ishte: Shuma tek zëri i parashikuar në buxhet për botime dhe pjesëmarrje në konferenca t'u shpërndahet të gjithë pedagogëve të UV-së (vetëm stafit akademik me kohë të plotë dhe që mban minimumi gradën shkencore doktor Shkencash) sipas kërkesave të tyre. Kjo shumë nuk mund të kalojë vlerën e 120.000 lekë për vit akademik.

Bëhet: Shuma tek zëri i parashikuar në buxhet për botime dhe pjesëmarrje në konferenca t'u shpërndahet të gjithë pedagogëve të UV-së (stafit akademik me kohë të plotë pavarësisht gradës shkencore që ai mban) sipas kërkesave të tyre. Kjo shumë nuk mund të kalojë vlerën e 120.000 lekë për vit akademik.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik, Administratori, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliq

Handwritten signature

